



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS

NOTER JULED A. BEQIRAJ
ADRESA NR.4, EGNATIA
TEL: 684050555

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 337

Nr. koleksioni: 195

Durres më 20/01/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2020011520282611275

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2020011520282611275

KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 20.01.2021, para meje Noter JULED A. BEQIRAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.4, EGNATIA, u paraqit personalisht:

DHURUES:

Reshard Kellici, atësia Zamir, shtetas Amerikan, lindur në Shqipëri dhe banues në Tiranë, lindur më 27/07/1981, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 517876667 dhe nr. personal 517876667, (Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Dhuruesi**")

PRANUES I DHURIMIT:

Lorin Hoxha, atësia Avni, amësia Lumturi, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Durrës, me adresë Rruga 'Iljaz Reka'; Nd. 0; H. 1; Ap. 40; Durrës; Durrës; 2001; Durrës, lindur më 27/06/1982, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036648649 dhe nr. personal I20627158A, (Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Përfituesi i dhurimit**")

Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noteri/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

OBJEKTI: Dhurimin e kuotes se shoqërisë "ALBANIAN STEVEDORING COMPANY (ASC)" sh.p.k ne mbështetje të ligjit "Per shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe neneve të Statutit të shoqërisë, në masën 5 %, që i përket ortakut **Z. RESHARD KELLICI** në favor të pranuesit të dhurimit **Z. LORIN HOXHA**.

Sipas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur deri në ditën e sotme të shoqërisë "ALBANIAN STEVEDORING COMPANY (ASC)" sh.p.k rezultoi se kjo shoqëri është regjistruar si person juridik me nr. NUIS K92128501U.

Objekti i shoqërisë është: "Ngarkim, shkarkim të mjeteve lundruese dhe aktiviteteve të ngjashme sic janë depozitimi, magazinimi, grupimi, marrja dhe dorezimi i ngarkesave etj. Servis".

Kjo shoqëri e ka selinë në Durres, rruga Tregtare, Lagja nr. 1, Porti Detar, pranë Zonës së Mirembajtjes Mekanike.

Dhuruesi dëshiron të kalojë përfituesit të dhurimit kuotën e tij që zotëron në këtë shoqëri dhe në masën 5%, Përfituesi i dhurimit me vullnetin e tij të lirë deklaroi se pranon këtë dhuratë dhe bëhet pronar i kësaj kuote, në masën 5% të kapitalit dhe si rrjedhojë **Z. LORIN HOXHA** bëhet me një kuotë në masën 30%.

1. Në përputhje me "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave", sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 « Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare » i ndryshuar, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë "Dispozitat e Përgjithshme për kontratën e dhurimit", hartohet kontrata e dhurimit si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, Dhuruesi i kalon Përfituesit të Dhurimit kuotën që përben 5 % të kapitalit të zotëruar në këtë shoqëri pa asnjë shpërblim (referuar Vendimit të Asamblesë së Ortakeve Nr. 1, datë 20.01.2021) si dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje duke e garantuar plotësisht për titullin e pronësisë.

Përfituesi i Dhurimit pranon dhurimin dhe kalimin e pronësisë së kuotes pa asnjë kundërshpërblim duke qenë mirënjohës ndaj Dhuruesit.

**Neni 2****Kalimi i pronësisë mbi kuoten**

Kalimi i pronësisë mbi kuoten nga Dhuruesi te Perfituesi i Dhurimit do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës.

Neni 3**Regjistrimi**

Regjistrimi i kalimit të kuotes do te kryhet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 4**Ligji i zbatueshëm**

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" si dhe dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 5**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Kontrata si u lexua dhe u gjet sipas vullnetit te paleve nenshkruhet vullnetarisht ne prani te noterit nga shitesit dhe bleresi dhe une noteri legalizoj nenshkrimet sipas ligjit.

Kontrata u redaktua ne kater kopje me fuqi te barabarte secila, ku njera prej tyre arkivohet ne kete zyre noteriale.

DHURUESI**PERFITUESI I DHURIMIT**

LESHARD KEJLICI

LORIN HOXHA

NOTER
JULED A. BEQIRAJ